

VENDIM
Nr. 7, datë 21.12.2018

RREGULLORE
PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR ZGJEDHJEN
E ZËVENDËSKRYETARËVE TË GJYKATAVE
(ndryshuar me vendimin e KLGJ-së nr. 137, datë 19.7.2019, nr. 324, datë 22.7.2021)

Mbështetur në ligjin nr. 115/2017, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 26, pika 6, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

Neni 1

1. Ky vendim përcakton rregulla të hollësishme për organizimin e procesit të zgjedhjes së zëvendëskryetarit të gjykatës.

Neni 2

1. Zëvendëskryetari zgjidhet gjyqtari i cili ka të paktën pesë vjet përvojë profesionale si gjyqtar, nga të cilat të paktën tre vjet në të njëjtën shkallë. Zëvendëskryetari i gjykatës ushtron kompetencat e kryetarit të mungesë të tij.

Neni 3

(ndryshuar pika 1 me vendimin e KLGJ-së nr. 324, datë 22.7.2021)

1. Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të gjykatës zgjedh zëvendëskryetarin, ndërmjet gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën në atë gjykatë, për një mandat trevjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme.

2. Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve thirret dhe kryesohet nga kryetari i gjykatës dhe në mungesë të tij thirret dhe kryesohet nga gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë në atë gjykatë.

Neni 4

1. Kancelari i gjykatës ndihmon kryesuesin e mbledhjes në përgatitjen e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve dhe është veçanërisht përgjegjës për:

- a) Njoftimin e gjyqtarëve për datën dhe orën e mbledhjes;
- b) Mbledhjen e shprehjes së interesit nga gjyqtarët që duan të kandidojnë sipas modelit aneks 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
- c) Përgatitjen e fletës së votimit sipas modelit aneksi 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
- c) Ngritjen e Komisionit të votimit;
- d) Numërimin e votave dhe shpalljen e rezultatit;
- dh) Merr masa për regjistrimin audio të mbledhjes; dhe
- e) Mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.

2. Në mungesë të Kancelarit këto përgjegjësi i ushtron Kryesekretari/ja e gjykatës dhe në mungesë të tij/saj nga sekretari/sekretarja me përvojën profesionale me të gjatë në atë gjykatë.

Neni 5

(ndryshuar fjalë në fjalinë e dytë të pikës 1 me vendimin e KLGJ-së nr. 324, datë 22.7.2021)

1. Në mbledhje kanë të drejtë të marrim pjesë të gjithë gjyqtarët me funksionin e gjyqtarit ose ndihmësmagjistratit në atë gjykatë. Mbledhja është e vlefshme kur në të marrim pjesë shumica e të gjithë anëtarëve. Gjyqtarët dhe ndihmësmagjistratët e pranishëm në mbledhje kanë për detyrë të votojnë.

2. Votimi është i hapur dhe vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Kur rezultati mes kandidatëve është i barabartë, zgjidhet kandidati me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar.

3. Para zhvillimit të mbledhjes, kryesuesi i mbledhjes verifikon përmbushjen e kriterëve të kandidatëve dhe përgatit listën e kandidatëve. Për këtë qëllim, kryesuesi i mbledhjes mund të kërkojë informacion nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Neni 6

1. Në fillim të mbledhjes, kryesuesi i saj lexon emrat e kandidatëve për pozicionin e zëvendëskryetarit të gjykatës dhe ngre komisionin e votimit. Në komisionin e votimit merr pjesë Kancelari, Kryesekretari/ja dhe sekretari/ja me përvojën profesionale me të gjatë në atë gjykatë. Në mungesë të Kancelarit ose të Kryesekretarit/es, vendin e tyre në komisionin e votimit e merr sekretari i radhës me përvojën më të gjatë profesionale në atë gjykatë. Në rast pamundësie, kryesuesi i seancës mund të ngrejë komisionin e votimit me një tjetër konfigurim me pjesëmarrjen e punonjësve të tjerë të gjykatës. Kancelari, dhe në mungesë të tij, Kryesekretari/ja drejton komisionin e votimit.

2. Komisioni i votimit shpërndan fletët e personalizuara të votimit për të gjithë të pranishmit. Fleta e votimit përmban emrat e kandidatëve, hapësirën për votimin dhe emrin e mbiemrin e gjyqtarit apo ndihmësmagjistratit votues. Votat mbledhen të gjitha në një kuti transparente.

3. Pas përfundimit të votimit, komisioni i votimit hap votat dhe lexon emrin e votuesit dhe emrin e kandidatit për të cilin ka votuar.

4. Vota në të cilën shprehja e vullnetit nuk është e qartë është e pavlefshme. Në çdo rast, gjatë leximit të votave, gjyqtari apo ndihmësmagjistrati votues, mund të konfirmojë vullnetin e tij.

5. Në përfundim të numërimit, kryesuesi i seancës shpall rezultatin dhe përcakton gjyqtarin i cili është zgjedhur për të ushtruar funksionin e zëvendëskryetarit.

Neni 7

(shtuar pika 2 me vendimin nr. 137, datë 19.7.2019 dhe ndryshuar pika 2 me vendimin nr. 324, datë 22.7.2021)

1. Kur numri i gjyqtarëve të gjykatës është dy, votimi nuk kryhet dhe gjyqtari që nuk është kryetar konsiderohet automatikisht si zëvendëskryetar. Në rast se asnjëri nga të dy gjyqtarët nuk është kryetar, përsëri votimi nuk kryhet dhe konsiderohet i zgjedhur si zëvendëskryetar gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë si gjyqtar. Në rast se ky i fundit refuzon, gjyqtari tjetër konsiderohet i zgjedhur si zëvendëskryetar. Në çdo rast, Kancelari i gjykatës dokumenton përzgjedhjen.

2. Në rastet kur nuk konkurrojnë kandidatë që plotësojnë kriterin e përvojës minimale profesionale ose kur asnjë nga gjyqtarët e gjykatës nuk e ka këtë përvojë, zëvendëskryetari i gjykatës zgjidhet ndërmjet gjyqtarëve të tjerë, që ushtrojnë funksionin në atë gjykatë, për një mandat njëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 8

1. Kancelari dokumenton të gjithë procesin e votimit dhe numërimit dhe harton listën e kandidatëve të renditur sipas numrit të votave të marra.

Neni 9

Dispozitë kalimtare

(shtuar me vendimin e KLGJ-së nr. 324, datë 22.7.2021)

Përfundimisht, deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas ligjit, kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së shkallës së parë duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar, ndërsa kandidati për zëvendëskryetar të gjykatës së apelit duhet të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si gjyqtar i gjykatës së apelit.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

ANEKSI 1

KËRKESË

PËR SHPREHJE INTERESI PËR POZICIONIN E ZËVENDËSKRYETARIT TË GJYKATËS

Drejtuar: Mbledhjes së gjyqtarëve

Këtu

Të nderuar pjesëmarrës,

Unë i nënshkruari _____, me detyrë, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë/Apelit _____, bazuar në nenin 26, pika 6, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit në Republikën e Shqipërisë”, paraqes kandidaturën time, për t’u zgjedhur në detyrën e zëvendëskryetarit të gjykatës.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptim, Ju uroj punë të mbarë.

Me konsideratë,

Gjyqtar

Gjykata e Shkallës së Parë/Apelit _____

Sot, në datën __.____.201__

ANEKSI 2

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË/APELIT _____

FLETA E VOTIMIT

PËR

ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARIN E GJYKATËS

Nr.	Emri mbiemri	Vota
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		

VOTUES:

(Emri, mbiemri)